



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM - ERZEN TIRANË

Nr. 1744/5 prot

Datë, 28 / 6 / 19

VENDIM

Nr. 12 Datë. 20 . 06 . 2019

PËR

MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR (PUS-SHPIM)
MARIKAJ VORË, PËR SUBJEKTIN "SALILLARI" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" i ndryshuar neni. 41 pika 1 gërma "e" neni. 50 pika 2; Vendimin nr. 416, datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", vendimit nr.221, datë 26.04.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore" paragrafi III, pika 5 gërma "i", vendimit nr.6, datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor" neni 11 pika 3 dhe vendimit nr.5, datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor" neni 7 pika 3, neni 16; Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

V E N D O S I :

- Miratimin e lejes për përdorimin e burimit ujor nëntokësor (pus-shpim) për subjektin "SALILLARI" shpk, me administrator z.Lulzim Salillari për qëllim teknologjik, me adresë; Marikaj Vorë, me këto të dhëna:

• Koordinatat : X = 470236 Y = 4584625	Z= 87 m
• Kapaciteti i pusit	0.0025 m ³ /s.
• Thellësia e pusit	80 m
• Volumi maksimal i ujit që kërkohet	0.0025 m ³ /s.
• Qëllimi i përdorimit :	Ujë teknologjik
• Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur	Përroi i Tones
- Ngarkohet ZABU Ishëm-Erzen-Mat për zbatimin dhe mbikqyrjen e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi mbas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETAR
Adrian SHTINO



KRYETAR
Suzana JAHOLLARI

